13. Kompozimi farmaceutik për përdorim i çdonjëit prej pretendimeve 4-12, ku CLD18A1 ka sekuencën aminoacide sipas SEQ ID NR: 8.

14. Kompozimi farmaceutik për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 3-13, ku antitrupi në fjalë është specifik për qelizat kancerogjene të stomakut.

15. Kompozimi farmaceutik për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 3-14, ku CLD18A2 në fjalë është shprehur në sipërfaqjen e qelizave në fjalë.

16. Një kompozim farmaceutik që përfshin nga një antitrup që lidhet me CLD18A2 dhe/ose një konjugat që përfshin antitrupin në fjalë të bashkuar me një agjent terapeutik, dhe një mbartës farmaceutikisht të pranueshëm, për përdorim në një metodë të trajtimit të metastazës të kancerit të stomakut,
ku antitrupi në fjalë është prodhuar nga një klon i depozituar nën aderimin nr. DSM ACC2737, DSM ACC2738, DSM ACC2739, DSM ACC2740, DSM ACC2741, DSM ACC2742, DSM ACC2743, DSM ACC2745, DSM ACC2746, DSM ACC2747, DSM ACC2748, DSM ACC2808, DSM ACC2809 ose DSM ACC2810.

17. Kompozimi farmaceutik për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 3-16, ku agjenti terapeutik në fjalë është një toksinë, një radioizotop, një bar ose një agjent citotoksik.

18. Kompozimi farmaceutik për përdorim i çdonjërit prej pretendimeve 3-17, ku metastaza e kancerit të stomakut në fjalë është një metastazë në nyjet limfatike.

(11) **11506**
(97) EP3368507/ 07.12.2022
(96) 16794175.6/ 28.10.2016
(22) 03.03.2023
(21) AL/P/2023/95
(54) **LIPIDE TE REJA DHE FORMULIME NANOPARTIKULASH TE LIPIDEVE PER ADMINISTRIMIN E ACIDEVE NUKLEIKE**
19.07.2023
(30) 201562247616 P,201662328244 P
(71) Acuitas Therapeutics Inc.
6190 Agronomy Road Suite 402 University of British Columbia - KETR
(72) ANSELL, Steven, M.;DU, Xinyao, 201 - 2010 West 8th Avenue;9580 Snowdon Avenue
(74) Ditika HOXHA (SHEHI)
Rr. "EMIN DURAKU", Pall.6/1, Ap.4-02, Tiranë
(57) 1. Një përbërje me strukture si me poshtë(IG): ose një kripë ose stereoizomer pharmaceutikisht i pranieshem i tij, ku: R1 dhe R2 janë secili në mënyrë të pavarur C6-C24 alkil ose C6-C24 alkenil; R3 është OR5, CN, -C(=O)OR4, -OC(=O)R4 ose -NR5C(=O)R4; R4 është C1-C12 alkil; R5 është H ose C1-C6 alkil; R6 është, në çdo dukuri, H; n është një numër i plotë që varion nga 2 në 12; dhe y dhe z janë secili në mënyrë të pavarur një numër i plotë që varion nga 6 në 9.

2. Përbërja e pretendimit 1, ku n është 3, 4, 5 ose 6.

3. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-2, ku R1 ose R2, ose të dyja, është C6-C24 alkenil.

4. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-2, ku R1 ose R2, ose të dyja, është C6-C24 alkil.

5. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-4, ku R1 dhe R2 secili në mënyrë të pavarur kanë strukturën e mëposhtme: Ku: R7a dhe R7b janë, në çdo rast, në mënyrë të pavarur H ose C1-C12 alkil; dhe a është një numër i plotë nga 2 në 12, mundësisht nga 8 në 12, ku R7a, R7b dhe a janë përzgjedhur në mënyrë që R1 dhe R2 secili të përmbajë në mënyrë të pavarur nga 6 deri në 20 atome karboni.

6. Përbërja e pretendimit 5, ku: a) të paktën një shfaqje e R7a është H; ose b) R7a është H në çdo dukuri; ose c) të paktën një shfaqje e R7b është C1-C8 alkil; ose d) të paktën një shfaqje e R7b është C1-C8 alkil dhe C1-C8 alkil është metil, etil, n-propil, izo-propil, n-butil, izo-butil, tert-butil, n-heksil ose n-oktil.

7. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-6, ku R1 ose R2, ose të dyja, ka një nga strukturat e mëposhtme:

8. Përbërja 3 secilit prej pretendimeve 1-7, ku R3 është OH.

9. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-7, ku: a) R3 është CN; ose b) R3 është -C(=O)OR4, -OC(=O)R4 ose -NHC(=O)R4, mundësisht ku R4 është metil ose etil.

10. Përbërja e pretendimit 1, që ka një nga strukturat e mëposhtme:

11. Nje perberje qe permban komponimin e secilit prej pretendimeve 1-10 dhe nje agjent terapeutik, mundesisht qe permban me tej nje ose me shume eksipient te zgjedhur nga lipide neutrale, steroid dhe lipide te konjuguara me polimer.

12. Përbërja e pretendimit 11, ku lipidi i konjuguar me polimer është një lipid i pegiluar që ka strukturën e mëposhtme (II): ose një kripë, tautomer ose stereoizomer e saj farmaceutikisht e pranueshme, ku: R8 dhe R9 janë secili në mënyrë të pavarur një zinxhir alkil i drejtë ose i degëzuar, i ngopur ose i pangopur që përmban nga 10 deri në 30 atome karboni, ku zinxhiri alkil ndërpritet opsionalisht nga një ose më shumë lidhje estere; dhe w ka një vlerë mesatare që varion nga 30 në 60.

13. Përbërja e pretendimit 12, ku: a)R8 dhe R9 janë secila vargje alkile të ngopura në mënyrë të pavarur, të drejtë, që përmbajnë nga 12 deri në 16 atome karboni; ose b) mesatarja w është rreth 49.

14. Përbërja e secilit prej pretendimeve 11-13, ku agjenti terapeutik përmban një acid nukleik, mundësisht ku acidi nukleik zgjidhet nga ARN antisens dhe mesazher.

15. Përbërja e secilit prej pretendimeve 1-10, ose perberja e cdonjerit prej pretendimeve 11-14, për përdorim në një metodë për administrimin e një agjenti terapeutik tek një pacient që ka nevojë për të.

---

(11) **11507**
(97) EP3501272/ 01.03.2023
(96) 18210518.9/ 13.03.2014
(22) 07.03.2023
(21) AL/P/2023/101
(54) **MINJ QË SHFAQIN NJË REPERTOR TË ZINXHIRIT TË LEHTË TË IMUNOGLOBULINËS TË KUFIZUAR**
19.07.2023
(30) 2.0131379846e+011
(71) Regeneron Pharmaceuticals, Inc.
777 Old Saw Mill River Road
(72) BABB, Robert;BUCKLER, David R.;DAVIS, Samuel;MACDONALD, Lynn;MCWHIRTER, John;MEAGHER, Karolina A.;MURPHY, Andrew J.;STEVENS, Sean, 10 Newton Court;115 Millard Avenue;16 Franklin Lane;211 Benjamin Boulevard;292 Voorhis Avenue;3954 Camino Calma;c/o Regeneron Pharmaceuticals, Inc.777 Old Saw Mill River Road
(74) Arben Kryeziu
Rr. Idriz DOLLAKU, Pall.5, Shk.2, Ap.39, Tirane, Albania, AL

(57)

1. Metodë për gjenerimin e një sekuence të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane, metodë e cila përfshin fazat e:

(a)imunizimit të një miu gjenetikisht të modifikuar me një antigen, ku miu gjenetikisht i modifikuar gjeneron antitrupa, kur ai është i imunizuar me një antigen, dhe ku miu gjenetikisht i imunizuar ka një genom të linjës embrionale që përbëhet nga:

(i)dy segmente të genit V_K të imunoglobulinës humane dhe pesë segmente të genit J_K të imunoglobulinës humane të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të lehtë të imunoglobilinës të një miu shtëpie ose miu arash, ku të dyja segmentet e genit V_K të imunoglobulinës humane janë një V_K1-39 humane dhe një V_K3-20 humane, dhe të pesë segmentet e genit J_K të imunoglobulinës humane janë JK1 humane, J_K2 humane, J_K3 humane, J_K4 humane dhe J_K5 humane; dhe

(ii)një ose më shumë segmente të genit V_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara , një ose më shumë segmente të genit D_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara, dhe një ose më shumë segmente të genit J_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës së miut;

ku segmentet e genit të zinxhirit të rëndë human të parisistemuara dhe segmentet e genit të zinxhirit të lehtë kappa humane të parisistemuara të miut janë të afta të risistemojnë dhe të kodifikojnë domainet variabël të zinxhirit të rëndë human dhe domeinet variabël të zinxhirit të lehtë kappa human, respektivisht, të një antitrupi, dhe ku miu nuk përmban një segment të genit V_K endogenoz dhe është i aftë të risistemohet për të formuar një sekuencë të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë, dhe

(b) përcaktimit të një sekuence të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane që kodifikon, respektivisht, një domein variabël të zinxhirit të rëndë ose të lehtë të imunoglobulinës humane, të një antitrupi që lidhet në

mënyrë specifike me antigenin dhe që gjenerohet nga miu i modifikuar gjenetikisht.

2. Metodë për gjenerimin e një sekuence të domeinit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane, metodë e cila përfshin fazat e:

(a) imunizimit të një miu gjenetikisht të modifikuar me një antigen interesi, ku miu gjenetikisht i modifikuar, në genomin e linjës embrionale të tij, përfshin:

(i)ekzaktësisht dy segmente të genit V_K të imunoglobulinës humane të parisistemuara dhe pesë segmente të genit J_K të imunoglobulinës humane të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale tek një sekuencë e regjionit konstant të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës të një miu, në vendndodhjet e zinxhirit të lehtë kappa endogjenoz të miut, ku të dyja segmentet e genit V_K të imunoglobulinës humane të parisistemuara janë një segment i genit V_K1-39 human dhe një segment V_K3-20 human, dhe të pesë segmentet e genit J_K të imunoglobulinës humane të parisistemuara janë J_K1 humane, J_K2 humane, J_K3 humane, J_K4 humane dhe J_K5 humane; dhe

(ii)një ose më shumë segmente të genit V_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara, një ose më shumë segmente të genit D_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara, dhe një ose më shumë segmente të genit J_H të imunoglobulinës humane të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës së miut në vendndodhjet e zinxhirit të rëndë endogjenoz të miut;

ku segmentet e genit të zinxhirit të lehtë kappa dhe zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës

humane të parisistemuara të miut të modifikuar gjenetikisht janë të afta të risistemojnë dhe kodifikojnë domeinet variabël të zinxhirit të rëndë human dhe domeinet variabël të zinxhirit të lehtë kappa human, respektivisht, të një antitrupi, dhe ku miu gjenetikisht i modifikuar nuk përmban segmente të genit J_K ose V_K të imunoglobulinës endogjenoze që janë të afta të risistemohen për të formuar një sekuencë të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës; dhe

(b) përcaktimin e një sekuence të domeinit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane të një antitrupi që lidhet në mënyrë specifike me antigenin dhe që gjenerohet nga miu gjenetikisht i modifikuar.

3. Metoda e pretendimit 2, ku përcaktimi i sekuencës së domeinit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane përfshin përcaktimin e një sekuence nukleotide që kodifikon sekuencën e domeinit variabël të zinxhirit të lehtë kappa dhe/ose të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane.

4. Metoda e pretendimeve 1 ose 2, ku genomi i linjës embrionale i miut gjenetikisht të modifikuar përmban me rradhë: segmentin e genit V_K1-39 human, segmentin e genit V_K3-20 human, segmentin e genit J_K1 human, segmentin e genit J_K2 human, segmentin e genit J_K3 human, segmentin e genit J_K4 human, dhe segmentin e genit J_K5 human,

5. Metoda e pretendimeve 1 ose 2, ku miu gjenetikisht i modifikuar përfshin një lokus të zinxhirit të lehtë λ të imunoglobulinës jofunksional.

6. Metoda e pretendimeve 1 ose 2, ku miu gjenetikisht i modifikuar nuk përmban një segment të genit V_H të imunoglobulinës të miut endogjenoz të aftë për t'u risistemuar për të formuar një regjion variabël të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës.

7. Metodë për prodhimin e një antitrupi, metodë e cila përfshin:

(1)shfaqjen në një qelizë të vetme:

(a) e një sekuencë të parë të acidit nukleik që kodifikon një zinxhir të parë të rëndë të imunoglobulinës, ku sekuenca e acidit nukleik e parë përmban një sekuencë të parë të regjionit variabël të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane e lidhur në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane, ku sekuenca e parë e regjionit variabël e zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane përftohet nga një qelizë B e një miu gjenetikisht të modifikuar, ku miu gjenetikisht i modifikuar është i imunizuar me një antigen të parë interesi dhe miu gjenetikisht i modifikuar përmban në genomin e linjës së tij embrionale:

(i)dy segmente të genit V_K humsn të parisistemuara dhe pesë segmente të genit J_K human
të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të
zinxhirit të lehtë, ku të dyja segmentet e genit V_K human të parisistemuara janë një segment i
genit V_K1-39 human dhe një segment i genit V_K3-20 human, dhe ku të pesë segmentet e genit
J_K human të parisistemuara janë një segment i genit J_K1 human, një segment i genit J_K2
human, një segment i genit J_K3 human, një segment i genit J_K4 human, dhe një segment i genit
J_K5 human; dhe
(ii)një ose më shumë segmente të genit V_H human të parisistemuara, një ose më shumë
segmente të genit D_H human të parisistemuara, dhe një ose më shumë segmente të genit J_H
human të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit
konstant të zinxhirit të rëndë të miut;

ku segmentet e genit të zinxhirit të rëndë human të parisistemuara dhe segmentet e genit të zinxhirit të lehtë kappa human të parisistemuara të miut gjenetikisht të modifikuar janë të afta për të risistemuar dhe kodifikuar domeinet variabël të zinxhirit të rëndë human dhe domeinet variabël të zinxhirit të lehtë kappa human të një antitrupi, respektivisht;
ku miu gjenetikisht i modifikuar nuk përmban një segment të genit V_K endogjenoz që
është i aftë të risistemohet për të formuar një sekuencë të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë; dhe
ku sekuenca e parë e regjionit variabël e zinxhirit të rëndë human kodifikon një domein të parë variabël të zinxhirit të rëndë human që, me një domein variabël të zinxhirit të lehtë kappa, pranon antigenin e parë; dhe

(b)e një sekuence të dytë të acidit nukleik që kodifikon një zinxhir të lehtë të imunoglobulinës , ku kjo sekuencë e dytë e acidit nukleik përmban një sekuencë të regjionit variabël të zinxhirit të lehtë kappa human lidhur në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të lehtë human, ku sekuenca e regjionit variabël e zinxhirit të lehtë kappa human përbëhet nga: një segment i genit V_K1-39 human, një segment i genit V_K3-20 human, ose një version somatikisht i hipermutuar i tyre;

(2)mbajtjen e qelizës në kushte të mjaftueshme për të shprehur një antitrup plotësisht human ; dhe
(3)izolimin e antitrupit.

8. Metoda e pretendimit 7, ku të dyja segmentet e genit V_K human të parisistemuara dhe pesë segmentet e genit J_K human të parisistemuara në genomin e linjës embrionale të miut gjenetikisht të modifikuar janë të lidhur në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant $_K$ të zinxhirit të lehtë të miut.

9. Metoda e pretendimit 7, ku të dyja segmentet e genit V_K human të parisistemuara dhe të pesë segmentet e genit J_K human të parisistemuara në genomin e linjës embrionale të miut gjenetikisht të modifikuar janë të pranishme tek një lokus i zinxhirit të lehtë të imunoglobulinës endogjenoze.

10. Metoda e pretendimit 7, ku genomi i linjës embrionale të miut gjenetikisht të modifikuar përmban me rradhë: segmentin e genit V_K1-39 human, segmentin e genit V_K3-20 human, segmentin e genit J_K1 human, segmentin e genit J_K2 human, segmentin e genit J_K3 human, segmentin e genit J_K4 human, dhe segmentin e genit J_K5 human.

11. Metoda e pretendimit 7, ku një ose më shumë segmentet e genit V_H human të parisistemuara, një ose më shumë segmentet e genit D_H human të parisistemuara, dhe një ose më shumë segmentet e genit J_H human të parisistemuara në genomin e linjës embrionale të miut gjenetikisht të modifikuar janë të pranishme në lokusin e zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës endogjenoze .

12. Metoda e çdonjerit prej pretendimeve 7-11, ku qeliza përmban një sekuencë të tretë të acidit nukleik që kodifikon një zinxhir të rëndë të dytë të imunoglobulinës humane, ku kjo sekuencë e tretë e acidit nukleik përfshin një regjion të dytë variabël të imunoglobulinës humane të lidhur në mënyrë funksionale me një regjion konstant të zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane , ku sekuenca e dytë e regjionit variabël e zinxhirit të rëndë të imunoglobulinës humane përftohet nga një qelizë B e një miu të dytë gjenetikisht të modifikuar, ku miu i dytë gjinetikisht i modifikuar është i imunizuar me një antigen të dytë interesi dhe miu i dytë gjenetikisht i modifikuar përmban në genomin e linjës së tij embrionale:

(i)dy segmente të genit V_K human të parisistemuara dhe pesë segmente të genit J_K human të parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të zinxhirit të lehtë, ku të dyja segmentet e genit V_K human të parisistemuara janë një segment i genit V_K1-39 human dhe një segment i genit V_K3-20 human, dhe ku të pesta segmentet e genit J_K human janë një segment i genit J_K1 human, një segment i genit J_K2 human, një segment i genit J_K3 human, një segment i genit J_K4 human, dhe një segment i genit J_K5 human; dhe

(ii)një ose më shumë segmente të genit V_H human të parisistemuara, një ose më shumë segmente të

genit D_H human të parisistemuara dhe një ose më shumë segmente të genit J_H human të
parisistemuara të lidhura në mënyrë funksionale me një sekuencë të regjionit konstant të
zinxhirit të rëndë të një miu;

ku segmentet e genit të zinzhirit të rëndë human të parisistemuara dhe segmentet e genit
të zinxhirit të lehtë kappa human të parisistemuara të miut gjenetikisht të modifikuar janë
të afta të risistemojnë dhe kodifikojnë domeinet variabël të zinxhirit të rëndë human dhe
domeinet variabël të zinxhirit të lehtë kappa human të një antitrupi, respektivisht;
ku miu gjenetikisht i modifikuar nuk përmban një segment të genit V_K endogjenoz që
është i aftë për t'u risistemuar për të formuar një sekuencë të regjionit variabël të
zinxhirit të lehtë; dhe
ku sekuenca e dytë e regjionit variabël e zinxhirit të rëndë human kodifikon një domein të
dytë variabël të zinxhirit të rëndë human, që, me një domein variabël të zinxhirit të lehtë
kappa, pranon antigenin e dytë,

ku:

- antigeni i parë dhe antigeni i dytë janë të ndryshme;
- zinxhiri i lehtë i imunoglobulinës i kodifikuar nga sekuenca e dytë e acidit nukleik në fjalë,
kur çiftohet me zinxhirin e rëndë të parë të imunoglobulinës humane , lidhet në mënyrë
specifike me antigenin e parë, dhe kur çiftohet me zinxhirin e rëndë të dytë të imunoglobulinës
lidhet në mënyrë specifike me antigenin e dytë; dhe
-antitrupi i prodhuar me anë të metodës është një antitrup bispecifik.

---

(11) **11508**
(97) EP3928818/ 01.02.2023
(96) 21164664.1/ 04.05.2015
(22) 09.03.2023
(21) AL/P/2023/102
(54) **NEBULIZATOR DHE KONTENIER**
20.07.2023
(30) 14001603
(71) Boehringer Ingelheim International GmbH
Binger Strasse 173

(72) EICHER, Joachim;HOELZ, Hubert;MEISENHEIMER, Martin;SCHULZ, Joern-Eric;WACHTEL, Herbert, Boehringer Ingelheim GmbH Corporate Patents Binge Str.173
(74) Ela SHOMO PANIDHA
Euromarkpat Albania SH.P.K , Rr. A.Z. Çajupi, Pall. 20/4, Ap.15, Tiranë
(57)

1. Nebulizator (1) i cili është konfiguruar për të nebulizuar një lëng (2), ku nebulizatori (1) përmban:

    një konteiner të zëvendësueshëm (3) që përmban lëngun (2);
    një veshje për nebulizatorin (24) e konfiguruar të pranojë konteinerin (3), ku veshja e nebulizatorit (24) përmban një pjesë veshëse (18) e cila mund të shkëputet nga nebulizatori (1) për të hapur veshjen e nebulizatorit (24) dhe për të zëvendësuar konteinerin (3); dhe
    një pajisje treguese (25) e konfiguruar për të numëruar dhe/ose për të treguar një numër përdorimesh të kryera ose ende të mundshme me konteinerin (3), ku përdorimet e përmendura përfshijnë procese tendosëse dhe/ose shpërndarëse gjatë të cilave konteineri (3) lëviz brenda veshjes së nebulizatorit (24) të mbyllur në një mënyrë si goditje,
    ku pajisja treguese (25) përmban një veshje të treguesit (31);
    ku pajisja treguese (25) është e bashkuar në mënyrë të pandashme me konteinerin (3), por
    është e ndashme nga veshja e nebulizatorit (24) dhe pjesa veshëse (18), në mënyrë të tillë që të jetë e zëvendësueshme sëbashku me konteinerin (3); dhe
    ku pajisja treguese (25) përmban një pjesë bllokuese të konfiguruar për të parandaluar përdorimin e mëtejshëm të konteinerit (3) në një gjendje të bllokuar të pajisjes treguese (25) kur një numër i paracaktuar përdorimesh është arritur ose tejkaluar me konteinerin (3),
    ku në gjendjen e bllokuar, pjesa bllokuese bllokon lëvizshmërinë si goditje të plotë të konteinerit (3) në veshjen e nebulizatorit të mbyllur (24),
    dhe
    ku pjesa bllokuese është integruar në veshjen e treguesit dhe/ose formon pjesë të veshjes së treguesit (31) ose është sistemuar brenda veshjes së treguesit (31).

2. Nebulizator (1) sipas pretendimit 1, i karakterizuar në atë që pjesa bllokuese është e lëvizshme paralelisht me një drejtim gjatësor ose shpërndarës të konteinerit (3) ose të nebulizatorit (1).

3. Nebulizator sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, i karakterizuar në atë që pajisja treguese (25) përmban një element tregues (35) i cili është konfiguruar të aktivizojë pjesën bllokuese në mënyrë të tillë që ajo të lëvizë nga një pozicion fillestar në veshjen e treguesit (31) në një pozicion bllokues.

4. Nebulizator sipas pretendimit 3, i karakterizuar në atë që pajisja treguese (25) përmban një sustë bllokuese (43) e cila është konfiguruar të parandalojë një lëvizje të pasme të pjesës bllokuese nga pozicioni bllokues në pozicionin fillestar.

5. Nebulizator sipas njërit prej pretendimeve të mëparshme, i karakterizuar në atë që pajisja treguese (25) përmban një element sinjali (34) ose flamur, ku elementi sinjal (34) ose flamuri i përmendur, kur aktivizohet gjendja e bllokuar e pajisjes treguese (25) dhe/ose kur numri i paracaktuar i përdorimeve të nebulizatorit (1) me konteinerin (3) është arritur ose tejkaluar dhe/ose kur konteineri (3) është bosh, bëhet i dukshëm ose më shumë i dukshëm dhe/ose tregon gjendjen e bllokuar të pajisjes treguese (25).

6. Nebulizator sipas pretendimit 5, i karakterizuar në atë që pjesa bllokuese formon ose është formuar nga elementi sinjal (34).

7. Nebulizator sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, i karakterizuar në atë që nebulizatori (1) përmban një pjesë drejtuese preferueshëm të palëvizshme (52) të konfiguruar për të drejtuar ose për të aktivizuar ose për të nxitur pajisjen treguese (25), veçanërisht nga lëvizja përkatëse e konteinerit (3) ose pajisjen treguese (25) tek veshja e nebulizatorit (24) ose e pjesës drejtuese (25).

8. Nebulizator sipas pretendimit 7, i karakterizuar në atë që pjesa bllokuese, në gjendjen e bllokuar, çaktivizon numërimin dhe/ose aktivizimin e një mekanizmi numërues në pajisjen treguese (25) dhe/ose çaktivizon një ndërveprim të pjesës drejtuese (52) me pajisjen treguese (25).

9. Nebulizator sipas pretendimit 7 ose 8, i karakterizuar në atë që pajisja treguese (25) përmban një hapje ndërfutëse (54) e cila lejon ndërfutjen e pjesës drejtuese (52) të nebulizatorit (1) dhe/ose ndërveprimin e pjesës drejtuese (52) me një element aktivizues (36) të pajisjes treguese (25) në gjendjen e zhbllokuar të pajisjes treguese (25).

10. Nebulizator sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, i karakterizuar në atë që pajisja treguese (25) është sistemuar fiksueshëm në një bazë (21) të konteinerit (3) dhe/ose përkundrejt një daljeje apo koke (28) të konteinerit (3), dhe/ose që pajisja treguese (25) është bashkuar nëpërmjet mbylljes me përshtatje ose nëpërmjet përshtatjes së formës me konteinerin (3).

---

(11) **11505**
(97) EP3537056/ 22.02.2023
(96) 19161427.0/ 07.03.2019
(22) 10.03.2023
(21) AL/P/2023/103
(54) **NJËSI E BRENDSHME E AJRIT TË KONDICIONUAR**
19.07.2023
(30) 2.0180000334e+011
(71) AERMEC S.p.A.

Via Roma 996
(72) Cavallo, Pierpaolo, Via Caporello, 11/B
(74) Krenar LOLOÇI
Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)
(57)
1. Njësia e ajrit të kondicionuar (1) që përfshin: një kontejner në formë kutie (2) e përshtatur për të marrë në hyrje një rrjedhë ajri (f) nga një burim i jashtëm aerolik; dhe të paktën një shkëmbyes nxehtësie (4) i cili është përshtatur për t'u kaluar nga një lëng transferues nxehtësie dhe që shtrihet ngjitur me kontejnerin në formë kutie (2) në mënyrë që të formojë/kufizojë, në një anë të kontejnerit në formë kutie (2), një hendek përkatës (5);

kontejneri në formë kutie (2) është i zgjatur në formë dhe është i pajisur gjithashtu me një seri hapjesh të daljes së ajrit (6) të përshtatura për të drejtuar, brenda hendekut të përmendur (5), rrymat përkatëse të ajrit (g) të përshtatura për të krijuar një lëvizje konvektive shtesë që drejton ajrin e ambientit përmes shkëmbyesit të nxehtësisë (4); dhe me një prerje gjatësore ose dhëmbëzim (7) i cili është projektuar për të akomoduar shkëmbyesin(ët) e nxehtësisë (4) dhe ka një seksion kryq në formë thelbësisht W; hapjet e daljes së ajrit (6) të vendosura në murin e poshtëm (9) të prerjes gjatësore ose dhëmbëzimit (7);
njësia e përmendur e ajrit të kondicionuar (1) që përfshin gjithashtu një ose më shumë hinkë konvergjente (10), secila prej të cilave bashkohet me një hapje përkatëse të daljes së ajrit (6) për të reduktuar rënien e presionit të ajrit që rrjedh nga kontejneri i ngjashëm me kutinë (2) përmes së njëjtës hapje të daljes së ajrit (6);
njësia e përmendur e ajrit të kondicionuar (1) e karakterizuar në atë që njësia e përmendur është e pajisur me dy shkëmbyes nxehtësie të zgjatur (4) me një strukturë të ngjashme me pllakën, të cilët vendosen/përmbahen brenda prerjes gjatësore ose dhëmbëzimit (7) krah për krah një tjetër dhe janë rregulluar në mënyrë që të formojnë një V me kokë poshtë; çdo shkëmbyes nxehtësie i zgjatur (4) që shtrihet gjithashtu brenda zgavrës gjatësore ose dhëmbëzimit (7) në mënyrë të thelbësisht lokalisht i zhveshur mbi një pjesë përkatëse anësore të sheshtë (9b) të murit të poshtëm (9) të prerjes gjatësore ose dhëmbëzimit (7) në mënyrë që të formohet një hendek përkatës gjatësor (5).

2. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas pretendimit 1, ku hinka konvergjente (10) ka një profil në formë briri ose gypi.
3. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas pretendimit 1 ose 2, ku hinka konvergjente (10) është e rregulluar brenda kontejnerit në formë kutie (2), në mbështetje kundër murit të kontejnerit në formë kutie (2) në të cilën ndodhet hapja përkatëse e daljes së ajrit (6).
4. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hinka konvergjente (10) shtrihet në mënyrë thelbësisht koaksiale në një bosht referimi (A) në mënyrë lokale thelbësisht pingul me rrafshin e shtrimit të hapjes përkatëse të daljes së ajrit (6).
5. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku çdo shkëmbyes nxehtësie (4) është rregulluar pranë një shiriti të sheshtë anësor përkatës (9b) të murit të poshtëm (9) të prerjes gjatësore ose dhëmbëzimit (7) në mënyrë që për të formuar një hendek gjatësor (5) me një profil konvergjent-divergjent drejt grykës së prerjes gjatësore ose dhëmbëzimit (7).
6. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hapjet e daljes së ajrit (6) janë të rregulluara në murin e poshtëm (9) të prerjes ose dhëmbëzimit

gjatësor (7) në mënyrë që të formojnë të paktën dy rreshta drejtvizor ngjitur. janë paralele me një bosht gjatësor (L) të kontejnerit të ngjashëm me kutinë (2) dhe secila është e rreshtuar në nivel lokal/përballë një hendeku gjatësor përkatës (5).
7. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku hinkat konvergjente (10) janë të inkorporuara në të paktën një shufër gjatësore (11) e cila është e vendosur në mbështetje kundër murit të kontejnerit të ngjashëm me kutinë (2), menjëherë mbi të paktën një seksion të rreshtit të përmendur të hapjeve të daljes së ajrit (6), në mënyrë që çdo hinka konvergjente (10) të jetë në linjë me një hapje përkatëse të daljes së ajrit (6) të seksionit të përmendur të rreshtit të hapjeve.
8. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku njësia e përmendur ka një hinkë konvergjente (10) në çdo hapje të daljes së ajrit (6).
9. Njësia e ajrit të kondicionuar sipas secilit prej pretendimeve të mëparshëm, ku muri i poshtëm (9) ka një shirit qendror të sheshtë (9a) dhe dy shirita të sheshtë anësore (9b) që janë të prirur në lidhje me shiritin e sheshtë qendror (9a) dhe janë të lidhura me shiritin e sheshtë qendror me dy palosje gjatësore në formë thelbësisht S (9c); hapjet e daljes së ajrit (6) duke u vendosur në dy palosjet gjatësore (9c).

---

(11) **11509**
(97) EP3497043/ 21.12.2022
(96) 17755450.8/ 09.08.2017
(22) 10.03.2023
(21) AL/P/2023/104
(54) **SISTEM NGARKUES PËR PALETIMIN E PRODUKTEVE TË PËRZIERA NË NJË PALET TARGET**
20.07.2023
(30) 1.0201611473e+011,1.0201611566e+011
(71) Brandmüller, Ludwig
Auerbachweg 28
(72) Brandmüller, Ludwig;Fellner, Herbert, Auerbachweg 28;Frankenstraße 7d
(74) Krenar LOLOÇI
Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)
(57)
1. Sistem ngarkues për paletimin e produkteve të përziera (2) në një palet target (8), që ka

- të paktën dy konvejerë furnizues (4) për produktet (2) për t'u paletuar,
- një gjenerator model paketimi (32) për kontrollin e sistemit ngarkues sipas një modeli paketimi që varet nga tipi i produkteve (2) për t'u vënë në paletin target (8),
- një pllakë ngarkuese (12),
- të paktën një kokë mbërthyese (16, 18) e cila është konfiguruar të marri të paktën njërin produkt (2) nga njëri prej konvejerët furnizues (4) në një sekuencë të paracaktuar dhe ta grupojë në pllakën ngarkuese (12),

në mënyrë që të paktën dy, preferimisht më shumë, grupe të produktit të sistemohen në pllakën ngarkuese dhe pllakat ngarkuese (12) vendosen të sistemuara në një distancë (a) përkundrejt njëra tjetrës dhe ku pllaka ngarkuese (12) është e lëvizhme për tej ose e ndashme nën grupet e produktit në drejtimin horizontal për transferimin të paktën të dy grupeve të produktit tek paleti target (8).

2. Sistem ngarkues sipas pretendimit të patentës 1, ku grupet e produktit konstruktohen nivel pas niveli përafërsisht paralel, ku një nivel i një grup produkti mund të përmbajë një tërësi produktesh (2) të marra si grupe të ndërmjetëm nga koka mbërthyese (16, 18) nga konvejeri furnizues (4).

3. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, që përmban një pajisje çentruese (28) për shtyrjen e grupeve të produktit së bashku përafërsisht në përmasën e paletit target (8).

4. Sistem ngarkues sipas pretendimit të patentës 3, ku pajisja çentruese (28) përmban pesë panele rrëshqitëse (30a, 30b, 30c, 30d) që udhëzohen në mënyrë rrëshqitëse së bashku në drejtimin e shtytjes dhe dy prej të cilave mund të rrëshqasin më vehte për të hapur një rrugë transporti.

5. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, ku grupet e produktit mbahen preferimisht nga pajisja çentruese (28) gjatë transferimit tek paleti target (8).

6. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, ku koka mbërthyese (16, 18) ka të paktën katër pllaka mbërthyese (20a, 20b, 20c, 20d) që janë të sistemuara afërsisht në këndet e djathtë ndaj njëra tjetrës dhe që mund të sillen në kontakt anësor me produktin (2) ose më një grup produkti me qëllim që ta mbajë atë, dhe që përmban një udhëzues për lëvizjen e kokës mbërthyese (16, 18) në drejtimin X, Y, dhe/ose Z.

7. Sistem ngarkues sipas pretendimit të patentës 6, ku të paktën njëra pllakë mbërthyese (20) pajiset me një pajisje për mbështetjen dhe çentrimin e produktit (2) ose të grupit të produktit.

8. Sistem ngarkues sipas pretendimit të patentës 7, ku çdo pllakë mbërthyese (20) pajiset me një kollonë çentruese (88, 90, 92, 94) që udhëzohet në mënyrë të përshtatshme në një krah mbërthyes (42, 44, 46, 48) që mban pllakën mbërthyese (20), në mënyrë që produkti (2) të mbështetet preferimisht në njërin pozicion të kollonës çentruese (88, 90, 92, 94) dhe çentrimi bëhet në një pozicion tjetër.

9. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, që përmban një kokë krrabë e cila konfigurohet të marrë, në një sekuencë përsëritse, të paktën një produkt (2) nga njëri prej konvejerëve furnizues (4) dhe ta vendosë atë në paletin target (8).

10. Sistem ngarkues sipas pretendimit të patentës 9, ku koka krrabë konfigurohet me një teh thike.

11. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, që përmban një mbledhës unazë flete peshë-përshtatëse për të siguruar produktet (2).

12. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, ku të paktën katër konvejerë furnizues paralel (4) dhe një rryp shkarkues (34) janë prezent, ku koka mbërthyese (16, 18) dhe/ose koka krrabë shoqërohen me konvejerët furnizues (4).

13. Sistem ngarkues sipas njërit prej pretendimeve të mëparshëm të patentës, me një ekran për shikueshmërinë e modelit të paketimit përpara dhe pas marrjes.

(11) **11510**
(97) EP3870574/ 04.01.2023
(96) 19789997.4/ 23.10.2019
(22) 10.03.2023
(21) AL/P/2023/105
(54) **DERIVATET AMINOPIRIMIDINE/PIRAZINES SI FRENUES TË CTPS1**
20.07.2023
(30) 18202136,PCT/EP2018/086617,PCT/EP2019/057320
(71) Step Pharma S.A.S.
101 rue de Sevres
(72) AHMED, Saleh;BIRCH, Louise;BLACKHAM, Emma;COUSIN, David;DUFFY, Lorna;GEORGE, Pascal;JONES, Geraint;NOVAK, Andrew;QUDDUS, Abdul;WRIGGLESWORTH, Joseph, c/o Step Pharma S.A.S. 101 rue de Sevres;c/o Sygnature Discovery Ltd, BioCity Pennyfoot Street;c/o Sygnature Discovery Ltd,BioCity Penny foot Street;c/o Sygnature Discovery Ltd,BioCity Pennyfoot Street
(74) Krenar LOLOÇI
Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)
(57)
1. Një përbërje e cila është 4-(2-(ciklopropanesulfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro-2H-piran-4-karboksamid:



ose një kripë dhe/ose solvat i saj.
2. Përbërja 4-(2-(ciklopropanesulfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro2H-piran-4-karboksamid:



,

ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvat i saj sipas pretendimit 1.
3. Kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe solvati i 4-(2-(ciklopropanesulfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro-2H-piran- 4-karboksamid:



sipas pretendimit 2.

4. Solvati farmaceutikisht i pı ılfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro-2H-piran-4-karboksamid:



sipas pretendimit 2.

5. Kripa farmaceutikisht e pranueshme e 4-(2-(ciklopropanesulfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro-2H-piran-4-karboksamid:



sipas pretendimit 2.

6. Përbërja sipas pretendimit 1 e cila është 4-(2-(ciklopropanesulfonamido)pirimidine-4-il)-N-(5-(6-etoksipirazine-2-il)piridine-2-il)tetrahidro-2H-piran-4-karboksamid:



.

7. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas çdonjërit prej pretendimeve 2 deri në 6 për përdorim si medikament.

8. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 7, për përdorim në reduktimin e proliferimit të qelizave-T dhe/ose qelizave-B në një subjekt.
9. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 7, për përdorim në trajtimin ose profilaksinë e: sëmundjeve inflamatore të lëkurës si psoriasis ose liken planus; GVHD akute dhe/ose kronike të tilla si GVHD akute rezistente ndaj steroideve; sindromi limfoproliferativ akut (ALPS); lupus eritematoz sistemik, lupusi nefriti ose lupusi i lëkurës; ose transplantimi; ose për përdorim në trajtimin ose profilaksinë e miastenisë gravis, sklerozës së shumëfishtë ose sklerodermes/sklerozës sistemike; ose për përdorim në përmirësimin e rikuperimit nga dëmtimi vaskular ose operacioni dhe reduktimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë të lidhur me neointimën dhe restenozën në një subjekt.
10. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 7, për përdorim në trajtimin e kancerit.
11. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 10, ku kanceri është një kancer hematologjik.
12. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 11, ku kanceri hematologjik është zgjidhur nga grupi i përbërë nga leuçemia mieloide Akute, limfoma me qeliza T Angioimunoblastike, leuçemia limfoblastike akute e qelizave B, Sindroma Sweet, limfoma e qelizave-T Jo-Hodgkins (duke përfshirë vrasësin natyror/limfoma e qelizave-T, leuçemia/limfoma e qelizave T të rriturve, limfoma e qelizave-T tipi enteropati, limfoma e qelizave-T hepatosplenike dhe limfoma e qelizave-T të lëkurës), leuçemia akute limfoblastike e qelizave-T, limfoma Jo-Hodgkins e qelizave-B (duke përfshirë limfomën Burkitt, limfomen difuze e qelizave të mëdha-B, limfomen Folikulare, limfomen e qelizave Mantele, limfomen e Zonës Margjinale), Leuçemia e Qelizave me Qime, limfoma Hodgkin, limfoma Limfoblastike, limfoma Limfoplazmocitike, limfoma e indit limfoid të lidhur me Mukozën, mieloma e Shumëfishtë, sindroma Mielodisplastike, mieloma e qelizave Plazmatike, limfoma Primare mediastinale e qelizave-B, çrregullimet kronike mieloproliferative (të tilla si leuçemia mieloide kronike, mielofibroza primare, trombocitemia esenciale, policitemia vera) dhe leuçemia limfocitare kronike.

13. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 10, ku kanceri është një kancer jo-hematologjik.
14. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas pretendimit 13, ku kanceri jo-hematologjik është zgjedhur nga grupi i përbërë nga kanceri i vezikes urinare, gjirit, melanoma, neuroblastoma, mesotelioma malinje pleurale dhe sarkoma.
15. Përbërja, kripa farmaceutikisht e pranueshme dhe/ose solvati i saj sipas çdonjërit prej pretendimeve 7 deri në 14, për përdorim në një subjekt njerëzor.
16. Një përbërje farmaceutike që përfshin përbërjen, kripën farmaceutikisht të pranueshme dhe/ose solvatin e saj sipas çdonjërit prej pretendimeve 2 deri në 6.
17. Një përbërje e formulës (II) e cila është:



(II),

ku R është H ose C_{1-6}alkil, ose kripërat e tyre.

---

(11) **11511**
(97) EP3672949/ 21.12.2022
(96) 18772885.2/ 23.08.2018
(22) 15.03.2023
(21) AL/P/2023/114
(54) **DERIVATE TË 3-(1-OKSOISOINDOLIN-2-il)PIPERIDINE-2,6-DION DHE PËRDORIMET E TYRE**
21.07.2023
(30) 201762549225 P
(71) Novartis AG
Lichtstrasse 35
(72) BECKWITH, Rohan Eric John;BONAZZI, Simone;CERNIJENKO, Artiom;FAZAL, Aleem;TICHKULE, Ritesh Bhanudasji;VISSER, Michael Scott, Novartis Institutes for BioMedical Research Inc.,250 Massachusetts Avenue
(74) Krenar LOLOÇI
Rr. Ibrahim Rugova, P.1/1, Kati II, Tiranë, Shqipëri (Albania)
(57)
1. Një përbërje e Formulës (I'):



(I'),

ose një kripë, hidrat, tretës, stereisomer, ose tautomer farmaceutikisht i pranueshëm i saj, ku:

X_1 është CR_3;

është opsionalisht një lidhje dyfishe kur X_1 është CR_3 dhe R_3 mungon;

secila R_1 është në mënyrë të pavarur $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkil, $(C_1\text{-}C_6)$hidroksialkil, ose halogjen, ose

dy R_1 bashkë me atomet karbon te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë heterocikloalkil me 5- ose 6- elemente, ose

dy R_1, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë $(C_6\text{-}C_{10})$aril ose një unazë heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S;

R_2 është $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $-C(O)(C_1\text{-}C_6)$alkil, $-C(O)(CH_2)_{0\text{-}3}(C_6\text{-}C_{10})$aril, $-C(O)O(CH_2)_{0\text{-}3}(C_6\text{-}C_{10})$aril, $(C_6\text{-}C_{10})$aril, heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ose $(C_3\text{-}C_8)$cikloalkil, ku alkili është opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_4; dhe arili, heteroarili, dhe cikloalkili janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_5, ose

R_1 dhe R_2, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur

formojnë një unazë heterocikloalkil me 5- ose 6-elemente;

R_3 është H ose R_3 mungon kur

është një lidhje dyfishe;

secila R_4 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga $-C(O)OR_6$, $-C(O)NR_6R_{6'}$, $-NR_6C(O)R_{6'}$, halogjen, -OH, $-NH_2$, CN, (C_6-C_{10})aril, heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 4 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_3-C_8)cikloalkil, dhe unazë heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ku grupet aril, heteroaril, cikloalkil, dhe heterocikloalkil janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_7;

secila R_5 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga (C_1-C_6)alkil, (C_2-C_6)alkenil, (C_2-C_6)alkinil, (C_1-C_6)alkoksi, (C_1-C_6)haloalkil, (C_1-C_6)haloalkoksi, (C_1-C_6)hidroksialkil, halogjen, -OH, $-NH_2$, CN, (C_3-C_7)cikloalkil, heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_6-C_{10})aril, dhe heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ose

dy R_5, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_6-C_{10})aril ose një unazë heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10}, ose

dy R_5, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_5-C_7)cikloalkil ose një unazë heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_{10};

R_6 dhe $R_{6'}$, janë secila në mënyrë të pavarur H, (C_1-C_6)alkil, ose (C_6-C_{10})aril;

secila R_7 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga (C_1-C_6)alkil, (C_2-C_6)alkenil, (C_2-C_6)alkinil, (C_1-C_6)alkoksi, (C_1-C_6)haloalkil, (C_1-C_6)haloalkoksi, $-C(O)R_8$, $-(CH_2)_{0-3}C(O)OR_8$, $-C(O)NR_8R_9$, $-NR_8C(O)R_9$, $- NR_8C(O)OR_9$, $-S(O)pNR_8R_9$, $-S(O)_pR_{12}$, (C_1-C_6)hidroksialkil, halogjen, -OH, $-O(CH_2)_{1-3}CN$, $-NH_2$, CN, $-O(CH_2)_{0-3}(C_6-C_{10})$aril, adamantil, $-O(CH_2)_{0-3}$-heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_6-C_{10})aril, heteroaril monociklik ose biciklik me 5- deri në 10-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_3-C_7)cikloalkil, dhe heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ku alkili është opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{11}, dhe arili, heteroarili, dhe heterocikloalkili janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë zëvendësues secili në mënyrë të pavarur i zgjedhur nga halogjen, (C_1-C_6)alkil, (C_1-C_6)haloalkil, dhe (C_1-C_6)alkoksi, ose

dy R_7 bashkë me atomin karbon te i cili ata janë bashkangjitur formojnë një =(O), ose

dy R_7, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_6-C_{10})aril ose një unazë heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10}, ose

dy R_7 bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_5-C_7) cikloalkil ose një unazë heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10};

R_8 dhe R_9 janë secila në mënyrë të pavarur H ose $(C_1\text{-}C_6)$alkil;

secila R_{10} është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_1\text{-}C_6)$alkoksi, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkil, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkoksi, $(C_1\text{-}C_6)$hidroksialkil, halogjen, -OH, $-NH_2$, dhe CN, ose

dy R_{10} bashkë me atomin karbon te i cili ata janë bashkangjitur formojnë një =(O);

secila R_{11} është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga CN, $(C_1\text{-}C_6)$alkoksi, $(C_6\text{-}C_{10})$aril, dhe heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ku arili dhe heterocikloalkili janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë zëvendësues secili në mënyrë të pavarur i zgjedhur nga $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_1\text{-}C_6)$alkoksi, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkil, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkoksi, $(C_1\text{-}C_6)$hidroksialkil, halogjen, -OH, $-NH_2$, dhe CN;

R_{12} është $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkil, $(C_6\text{-}C_{10})$aril, ose heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S;

R_x është H ose D;

p është 0, 1, ose 2;

n është 0, 1, ose 2;

n1 është 1 ose 2, ku $n + n1 \leq 3$; dhe

q është 0, 1, 2, 3, ose 4.

2. Përbërja e pretendimit 1, që ka një Formulë (I):



(I),

ose një kripë, hidrat, tretës, stereisomer, ose tautomer farmaceutikisht i pranueshëm i saj, ku:

X_1 është CR_3;

$\overline{\text{------}}$ është opsionalisht një lidhje dyfishe kur X_1 është CR_3 dhe R_3 mungon;

secila R_1 është në mënyrë të pavarur $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_1\text{-}C_6)$haloalkil, $(C_1\text{-}C_6)$hidroksialkil, ose halogjen;

R_2 është $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_6\text{-}C_{10})$aril, heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ose $(C_3\text{-}C_8)$cikloalkil, ku alkili është opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_4; dhe arili, heteroarili, dhe cikloalkili janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_5;

R_3 është H ose R_3 mungon kur ------ është një lidhje dyfishe;

secila R_4 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga $-C(O)OR_6$, $-C(O)NR_6R_6$, $-NR_6C(O)R_{6'}$, $(C_6\text{-}C_{10})$aril, heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, $(C_3\text{-}C_8)$cikloalkil, dhe heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ku grupet aril, heteroaril, cikloalkil, dhe heterocikloalkil janë opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_7;

secila R_5 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga $(C_1\text{-}C_6)$alkil, $(C_2\text{-}C_6)$alkenil, $(C_2\text{-}$

C_6)alkinil, (C_1-C_6)alkoksi, (C_1-C_6)haloalkil, (C_1-C_6)haloalkoksi, (C_1-C_6)hidroksialkil, halogjen, -OH, -NH_2, CN, (C_3-C_7)cikloalkil, heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_6-C_{10})aril, dhe heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ose

dy R_5, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_6-C_{10})aril ose një unazë heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10}, ose

dy R_5, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_5-C_7)cikloalkil ose një unazë heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S opsionalisht të zëvendësuar me një ose më shumë R_{10};

R_6 dhe R_6, janë secila në mënyrë të pavarur H ose (C_1-C_6)alkil;

secila R_7 është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga (C_1-C_6)alkil, (C_2-C_6)alkenil, (C_2-C_6)alkinil, (C_1-C_6)alkoksi, (C_1-C_6)haloalkil, (C_1-C_6)haloalkoksi, -C(O)R_8, -C(O)OR_8, -C(O)NR_8R_9, -NR_8C(O)R_9, (C_1-C_6)hidroksialkil, halogjen, -OH, -NH_2, CN, (C_6-C_{10})aril, heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, (C_3-C_7)cikloalkil, dhe heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, ose

dy R_7, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_6-C_{10})aril ose një unazë heteroaril me 5- ose 6-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10}, ose

dy R_7, kur në atomet fqinje, bashkë me atomet te të cilët ata janë bashkangjitur formojnë një unazë (C_5-C_7)cikloalkil ose një unazë heterocikloalkil me 5- deri në 7-elemente që përfshin 1 deri në 3 heteroatome të zgjedhura nga O, N, dhe S, opsionalisht i zëvendësuar me një ose më shumë R_{10};

R_8 dhe R_9 janë secila në mënyrë të pavarur H ose (C_1-C_6)alkil;

secila R_{10} është në mënyrë të pavarur e zgjedhur nga (C_1-C_6)alkil, (C_1-C_6)alkoksi, (C_1-C_6)haloalkil, (C_1-C_6)haloalkoksi, (C_1-C_6)hidroksialkil, halogjen, -OH, -NH_2, dhe CN;

R_x është H ose D;

n është 1 ose 2; dhe

q është 0, 1, 2, 3, ose 4, në mënyrë të preferuar q është 0, 1, ose 2.

3. Përbërja sipas pretendimit 1 ose 2, ku n është 1.

4. Përbërja sipas pretendimit 1 ose 2, ku n është 2.

5. Përbërja sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku X_1 është CH.

6. Përbërja sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku R_x është H.

7. Përbërja sipas pretendimit 1, që ka një Formulë (Ia), Formulë (Ib), Formulë (Ic), ose Formulë (Id):



(Ia),



(Ib),



(Ic), ose



(Id).

8. Përbërja sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku R_2 është $(C_6\text{-}C_{10})$aril ose $(C_3\text{-}C_8)$cikloalkil, ku arili dhe cikloalkili janë opsionalisht të zëvendësuar me një deri në tre R_5, në mënyrë të preferuar R_2 është $(C_6\text{-}C_{10})$aril ose $(C_3\text{-}C_8)$cikloalkil.

9. Përbërja sipas çdo njërit prej pretendimeve 1-7, ku R_2 është $(C_1\text{-}C_6)$alkil opsionalisht i zëvendësuar me një deri në tre R_4.

10. Përbërja sipas pretendimit 1 e zgjedhur nga:
3-(5-(1-etilpiperidin-4-il)-1-oksoisoindolin-2-il)piperidine-2,6-dion;
3-(1-okso-5-(1-propilpiperidin-4-il)isoindolin-2-il)piperidine-2,6-dion;
3-(5-(1-(ciklopropilmetil)piperidin-4-il)-1-oksoisoindolin-2-il)piperidine-2,6-dion;
3-(5-(1-isobutilpiperidin-4-il)-1-oksoisoindolin-2-il)piperidine-2,6-dion;
3-(5-(1-(ciklobutilmetil)piperidin-4-il)-1-oksoisoindolin-2-il)piperidine-2,6-dion;
